# ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **613-26-1259-2-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | - |

Sa i përket tenderit për

**Mirëmbajtja e parkingut nëntokësore**

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

______ *Noi Construction shpk & Dashnim Jashari B.I*
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

__________ *Rr.Haxhi Kleqka, nr.99*
*(Adresa)*

______________ *Lipjan* ________________ *14000* ________________
*(Vendi)* *(Kodi postar)*

________ *045785649* ________________________________________
*(Numri Telefonit)* *(Numri i Faks-it)*

____________ *Labinot Dedushi* _______________________
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

*Noiconstruction.shpk@gmail.com* ____________
*(Adresa elektronike)*

_______ *25.05.2026* _________________
*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
NOI CONSTRUCTION
*LIPJAN*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

______________________________________________

*(Emri i avokatit)*

______________________________________________

*(Adresa e plotë)*

____________________ ____________________

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

____________________

*(Adresa elektronike)*

____________________ ____________________

*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

| |
|---|
| *Njoftimi per kontrate 16.03.2026*<br>*Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 19.03.2026*<br>*Dorezimi dhe hapja e tenderit 08.04.2026 14:09*<br>*Njoftim mbi vendimi e AK 30.04.2026 16:09*<br>*Leter standarde per tenderuesin e eleminuar 30.04.2026 16:09*<br>*Vendimi mbi vendimin e AK-se 08.05.2026* |

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

| |
|---|
| |

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [X] **Jo** [ ]

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

- Shkeljet ligjore te LPP-se dhe akteve tjera nen ligjore.
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
- Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 61 Çmimet jo normalisht te ulëta
- Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve Rregullorja për Prokurim Publik, 001/2022
- Neni 17 Dosja e tenderit Neni 41 Tenderët jo-normalisht te ulet
- Neni 97 Shkeljet e renda. Udhëzuesi për Prokurim Publik nr. 001/23
- Neni 10 Sqarimi i tenderëve

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Me daten 08.05.2026 permes e-prokurim@rks-gov.net nga AK kemi pranuar „Leter standarde per tenderuesin e eleminuar" ne lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: „**Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë** me nr. prokurimi: **613-26-1259-2-2-1**

***Grupi i Noi Construction Shpk & Dashnim Jashari B.I.*** **ushtrojn të drejtën e saj ligjore që përmes kësaj ankese të drejtuar Panelit të Organit shqyrtues të prokurimit, të argumentuar me prova dhe të bazuar në dispozitat përkatese ligjore, ta ankimoj vendimin e shpallur nga AK i cili vendim, është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore konkretisht ligjit te prokurimit publike ne Kosove.**

Fillimisht theksojmë se Autoriteti Kontraktues me daten 30.04.2026 e ka shpallur fitues nje OE te papapergjegshem GASHI EG Shpk por pas Kerkeses Per Rishqyrtim te cilen e kemi bere me daten 05.05.2026 **e ka pranuar ankesën** tonë si të bazuar lidhur me vendimin fillestar për dhënie të kontratës dhe lenden e ka kthyer ne RIVLERESIM. Kjo nënkupton se gjatë procesit të vlerësimit janë konstatuar parregullsi dhe shkelje procedurale nga ana e komisionit vleresues. Megjithatë, në vend që të bëhet rivlerësim i drejtë dhe objektiv i ofertave dhe të vazhdohet procedura në përputhje me kriteret e dosjes së tenderit, Autoriteti Kontraktues ka zgjedhur **anulimin e tërësishëm të aktivitetit** të prokurimit me arsyetime të paqëndrueshme dhe kontradiktore mes vendimit te pare te dates 30.04.2026 ku me qellim ka shpallur fitues nje OE te papergjegjeshem dhe vendimit te dyte te dates 08.05.2026 ku me qellim e anulon proceduren e prokurimit qe mos ta na shpalle fitues ne si OE te vetmit te pergjegjshem ne kete procedure te prokurimit.

Në arsyetimin e vendimit thuhet se kinse përshkrimi teknik dhe paramasa kanë krijuar "hamendësim" dhe "konfuzion" tek operatorët ekonomikë lidhur me pozicionin 2.2 dhe çështjen e largimit të automjeteve nga parkingu pas 24 orëve.

Ku ne paramase dhe parallogari Autoriteti Kontraktues ne pozicionin 2.2 ka kerkuar qe per cdo automjete te larguar pas qendrimit prej 24 ore te paguan Operatorin Ekonomik ne vlere nen 30 euro, **gje qe eshte ne rregull kjo se per qka ka kerkuar Autoriteti Kontraktues,** por tani per te krijuar hamendsim dhe per te **anuluar proceduren e prokurimit Autoriteti Kontraktues** citon se Komuna nuk mund te paguan Operatorin Ekonomik per largimin e Automjetit por duhet pronari I automjetit, gje qe kjo eshte e ndaluar me LIGJ, sepse asnje Kompani Private nuk mund te ja largon apo bllokon, apo konfiskon automjetin,

**Vemendje**: Ketu e kemi edhe nje shembull konkret te Gjykates Supreme te Kosoves e cila ka vendosur ne lidhje me Ndermarrjen Publike '' Prishtina Parking'' e cila ka cituar se as Nderrmarjet Publike e hiq me pak Kompanite Private te denojne pronaret e automjeteve por per kete eshte kompetent komuna.

Ky arsyetim nuk qëndron për faktin se gjatë gjithë periudhës së tenderimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim nga asnjë operator ekonomik lidhur me këtë pozitë apo me dokumentacionin tenderues sepse te gjitha pozicionet e paramases dhe parallogarise jane te qarta per punet te cilat kane per tu kryer.
Të gjithë operatorët ekonomikë kanë ofertuar në bazë të të njëjtit dokumentacion dhe të njëjtave kushte, sepse te gjitha kushtet kane qene te qarta.

Madje, vet fakti që janë pranuar oferta nga operatorë të ndryshëm ekonomikë dëshmon qartë se dosja e tenderit ka qenë e kuptueshme dhe e zbatueshme. Nuk mund të pretendohet pas përfundimit të procedurës dhe **pas pranimit të ankesës sonë se kane shpallur nje fitues te papergjegjshem, por per te mos na shpallur fitues ne si OE te vetmit te pergjegjshem, Autoriteti Kontraktues krijon hamendje** se dokumentacioni paska qenë i paqartë apo i interpretuar gabimisht.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues në vendimin e tij pretendon se nuk ka kapacitete financiare që për çdo automjet që qëndron mbi 24 orë në parking të marrë përgjegjësi financiare nga buxheti i komunës.
Ky pretendim **nuk mund të përdoret si bazë ligjore për anulimin e procedurës,** sepse çështja e menaxhimit të automjeteve dhe mënyra e largimit të tyre është kompetencë e vet Autoritetit Kontraktues dhe jo barrë financiare që duhet t'i ngarkohet Operatorit Ekonomik **pa bazë ligjore.**

Sipas kushteve të përcaktuara në dosje te tenderit , **Operatorit Ekonomik i është kërkuar që të bëjë largimin e automjeteve të cilat qëndrojnë më shumë se 24 orë në parking.** Mirëpo, Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë ligjore që barrën financiare të largimit të automjeteve ta transferojë tek Operatori Ekonomik, **pasi Operatori Ekonomik nuk është organ kompetent për shqiptimin e gjobave apo masave administrative ndaj qytetarëve**, respektivisht kundervatjeveve, **pasi qe menaxheri I kontrates ne fjale nga komuna e urdheron me shkrimin per largimin e automjetit gje qe nenkupton se operatori ekonomik fitues paguhet nga komuna, pasi qe e njejta e obligon.**

Komuna, si institucion publik dhe autoritet përgjegjës për menaxhimin e hapësirave publike dhe zbatimin e rregulloreve komunale, **ka të drejtë të shqiptojë tiketë/gjobë ndaj pronarit të automjetit që tejkalon afatin e lejuar të parkimit.** Pas marrjes së vendimit administrativ apo urdhrit për largim të automjetit, Komuna mund të angazhojë operatorin ekonomik për bartjen e automjetit dhe më pas ta kompensojë operatorin për shërbimin e kryer sipas kontratës.

Prandaj është e paarsyeshme dhe në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit dhe trajtimit të drejtë që **Operatori Ekonomik të obligohet të mbulojë me shpenzimet e veta largimin e automjeteve, ndërkohë që nuk posedon kompetenca publike për shqiptim të masave administrative apo inkasim të detyrimeve ndaj qytetarëve.**

Gjithashtu, ky arsyetim është paraqitur vetëm pas pranimit të ankesës sonë, çka krijon dyshim të bazuar se anulimi i aktivitetit nuk është bërë për arsye reale procedurale, por me qëllim të shmangies së shpalljes së operatorit tonë ekonomik si fitues të kontratës.

Konsiderojmë se me këtë veprim **janë cenuar parimet themelore të**:

- trajtimit të barabartë;
- proporcionalitetit;
- transparencës;
- konkurrencës së lirë dhe të ndershme;
- si dhe ekonomicitetit në procedurat e prokurimit publik.

Për më tepër, theksojmë se oferta jonë ka qenë oferta më e favorshme ekonomike dhe njëkohësisht oferta më e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. **Operatori ynë ekonomik ka përmbushur të gjitha kërkesat administrative, teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe ka ofertuar në përputhje të plotë me parametrat dhe specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.**

**Çmimi i ofertuar nga ana jonë është dukshëm më i ulët krahasuar me operatorët tjerë ekonomikë, duke i sjellë përfitim të drejtpërdrejtë buxhetit publik dhe duke respektuar parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit të parasë publike. Përkundër kësaj, në asnjë moment Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar se oferta jonë është e papërgjegjshme apo se nuk i plotëson kriteret e dosjes së tenderit.**

Përkundrazi, pas shqyrtimit të ankesës sonë, vet Autoriteti Kontraktues ka pranuar se gjatë vlerësimit fillestar ka pasur mangësi dhe parregullsi. **Kjo nënkupton qartë se operatori ynë ekonomik është dëmtuar padrejtësisht gjatë procesit të vlerësimit dhe se anulimi i mëvonshëm i procedurës është përdorur si mënyrë për të shmangur korrigjimin e atyre shkeljeve.**

Në këtë rast, anulimi i procedurës nuk mund të përdoret si mekanizëm për të eliminuar operatorin ekonomik që ka ofertuar çmimin më të favorshëm dhe që ka përmbushur kushtet e kërkuara. Një veprim i tillë bie ndesh me vet qëllimin e Ligjit për Prokurim Publik, i cili obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë trajtim të barabartë, konkurrencë të drejtë dhe shfrytëzim racional të parasë publike.

**Theksojmë se nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur paqartësi lidhur me mënyrën e zbatimit të ndonjë pozicioni teknik, ai ka pasur të drejtë dhe mundësi ligjore që gjatë administrimit të kontratës të bëjë sqarime operative dhe interpretim të drejtë të obligimeve kontraktuale, e jo të anulojë tërësisht procedurën vetëm pasi operatori ynë ekonomik ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave të veta.**

Për këtë arsye konsiderojmë se Operatori ynë Ekonomik duhet të trajtohet si operator i përgjegjshëm dhe fitues legjitim i këtij aktiviteti të prokurimit, duke qenë se:

- ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme;
- ka plotësuar kriteret e dosjes së tenderit
;- ka ofertuar çmimin më të ulët;
- nuk është konstatuar asnjë shkelje apo papërgjegjësi nga ana jonë;
- dhe anulimi i procedurës është bërë vetëm pas pranimit të ankesës sonë.

Prandaj, kërkojmë nga PANELI I ORGANIT SHQYRTUES TE PROKURIMIT të veprojë në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik dhe të qarteson shkeljet e Autoritetit Kontraktues ne kete procedure te prokurimit dhe lenden te kthen ne **RIVLERESIM**

- **DUKE U BAZUAR NE PROVAT, ARGUMENTET DESHMITE SI DHE SQARIMET E MESIPERME KERKOJME NGA OSHP , QE TE MERR NJE :**

**VENDIM**

- **APROVOHET** si e bazuar ankesa e grupit te OE; **Noiconstruction Shpk & Dashnim Jashari B.I**

- **ANULOHET** Njoftimi dhe Vendimi i AK ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit dhe lënda të kthehet ne **RIVLERSIM.**

- **DETYROHET** autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit, dhe konform dispozitave ligjore të LPP-së

**8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Dëmet financiare ne rast se vendimi nuk korigjohet janë jashtëzakonisht të më mëdha por dëmtimi me i madh i bëhet konkurrencës se ndershme dhe te drejtë.**
**Neve si kompani, eleminimi nga ky aktivetit i prokurimit na ka shkaktuar dëme si në aspektin financiar ne vlere prej 59,999.98 poashtu duke demtuar edhe thellësisht imazhin e kompanisë.**
**Humbja e kosteve te stafit kryesore si dhe ate teknik.**

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

1. *Njoftimi per kontrate 16.03.2026*
2. *Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 19.03.2026*
3. *Dorezimi dhe hapja e tenderit 08.04.2026 14:09*
4. *Njoftim mbi vendimi e AK 30.04.2026 16:09*
5. *Leter standarde per tenderuesin e eleminuar 30.04.2026 16:09*
6. *Vendimi mbi vendimin e AK-se 08.05.2026*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OFLIPJAN

**Departamenti i Prokurimit** **Data: 15.06.2026**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 13.05.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Noi Construction shpk, Lipjan rruga Haxhi Kleqka, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë "me nr prokurimit: 613-26-1259-2-2-1, Autoriteti kontraktues nxjerr:

## VENDIM

I. **Refuzohet e pa bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e paraqitur nga Operatori Ekonomik Noi Construction shpk, Lipjan rruga Haxhi Kleqka, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë "me nr prokurimit: 613-26-1259-2-2-1.

II. **Mbetet në fuqi Vendimi i** publikuara ne platformen e prokurimit te dates: 08.05.2026.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

## Arsyetim

Operatori Ekonomik Noi Construction shpk, Lipjan rruga Haxhi Kleqka, ka parashtuar kërkesë për Rishqyrtim me datë 13.05.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë "me nr prokurimit: 613-26-1259-2-2-1, ndërsa Autoriteti Kontraktues, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë me datë: 15.05.2026.

Pretendimet nga OE:

Në cilësinë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e lartcekur të prokurimit, paraqesim këtë ankesë/kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 08.05.2026, pasi konsiderojmë se vendimi i marrë është i pabazuar në aspektin juridik, procedural dhe faktik, si dhe është në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurim Publik.

Fillimisht theksojmë se Autoriteti Kontraktues paraprakisht e ka pranuar ankesën tonë si të bazuar lidhur me vendimin fillestar për dhënie të kontratës. Kjo nënkupton se gjatë procesit të vlerësimit janë konstatuar parregullsi dhe shkelje procedurale. Megjithatë, në vend që të bëhet rivlerësim i drejtë dhe objektiv i ofertave dhe të vazhdohet procedura në përputhje me kriteret e dosjes së tenderit, Autoriteti Kontraktues ka zgjedhur anulimin e tërësishëm të aktivitetit të prokurimit me arsyetime të paqëndrueshme dhe kontradiktore.

Në arsyetimin e vendimit thuhet se kinse përshkrimi teknik dhe paramasa kanë krijuar "keqkuptim" dhe "konfuzion" tek operatorët ekonomikë lidhur me pozicionin 2.2 dhe çështjen e largimit të automjeteve nga parkingu pas 24 orëve. Ky arsyetim nuk qëndron për faktin se gjatë gjithë periudhës së tenderimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim nga asnjë operator ekonomik lidhur me këtë pozitë apo me dokumentacionin tenderues. Të gjithë operatorët ekonomikë kanë ofertuar në bazë të të njëjtit dokumentacion dhe të njëjtave kushte, sepse te gjitha kushtet kane qene te qarta.

Madje, vet fakti që janë pranuar oferta nga operatorë të ndryshëm ekonomikë dëshmon qartë se dosja e tenderit ka qenë e kuptueshme dhe e zbatueshme. Nuk mund të pretendohet pas përfundimit të procedurës dhe pas pranimit të ankesës sonë se dokumentacioni paska qenë i paqartë apo i interpretuar gabimisht.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues në vendimin e tij pretendon se nuk ka kapacitete financiare që për çdo automjet që qëndron mbi 24 orë në parking të marrë përgjegjësi financiare nga buxheti i komunës. Ky pretendim nuk mund të përdoret si bazë ligjore për anulimin e procedurës, sepse çështja e menaxhimit të automjeteve dhe mënyra e largimit të tyre është kompetencë e vet Autoritetit Kontraktues dhe jo barrë financiare që duhet t'i ngarkohet Operatorit Ekonomik pa bazë ligjore.

Sipas kushteve të përcaktuara në dosje, Operatorit Ekonomik i është kërkuar që të bëjë largimin e automjeteve të cilat qëndrojnë më shumë se 24 orë në parking. Mirëpo, Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë ligjore që barrën financiare të largimit të automjeteve ta transferojë tek Operatori Ekonomik, pasi Operatori Ekonomik nuk është organ kompetent për shqiptimin e gjobave apo masave administrative ndaj qytetarëve, respektivisht kundervatjoveve, pasi qe menaxheri i kontrates ne fjale nga komuna e urdheron me shkrimin per largimin e automjetit gje qe nenkupton se operatori ekonomik fitues paguhet nga komuna, pasi qe e njejta e obligon.

Komuna, si institucion publik dhe autoritet përgjegjës për menaxhimin e hapësirave publike dhe zbatimin e rregulloreve komunale, ka të drejtë të shqiptojë tiketë/gjobë ndaj pronarit të automjetit që tejkalon afatin e lejuar të parkimit. Pas marrjes së vendimit administrativ apo urdhrit për largim të automjetit, Komuna mund të angazhojë operatorin ekonomik për bartjen e automjetit dhe më pas ta kompensojë operatorin për shërbimin e kryer sipas kontratës.

Prandaj është e paarsyeshme dhe në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit dhe trajtimit të drejtë që Operatori Ekonomik të obligohet të mbulojë me shpenzimet e veta largimin e automjeteve, ndërkohë që nuk posedon kompetenca publike për shqiptim të masave administrative apo inkasim të detyrimeve ndaj qytetarëve.

Gjithashtu, ky arsyetim është paraqitur vetëm pas pranimit të ankesës sonë, çka krijon dyshim të bazuar se anulimi i aktivitetit nuk është bërë për arsye reale procedurale, por me qëllim të shmangies së shpalljes së operatorit tonë ekonomik si fitues të kontratës.

Konsiderojmë se me këtë veprim janë cenuar parimet themelore të:
- trajtimit të barabartë;
- proporcionalitetit;
- transparencës;
- konkurrencës së lirë dhe të ndershme;
- si dhe ekonomicitetit në procedurat e prokurimit publik.

Për më tepër, theksojmë se oferta jonë ka qenë oferta më e favorshme ekonomike dhe njëkohësisht oferta më e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. Operatori ynë ekonomik ka përmbushur të gjitha kërkesat administrative, teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe ka ofertuar në përputhje të plotë me parametrat dhe specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Çmimi i ofertuar nga ana jonë është dukshëm më i ulët krahasuar me operatorët tjerë ekonomikë, duke i sjellë përfitim të drejtpërdrejtë buxhetit publik dhe duke respektuar parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit të parasë publike. Përkundër kësaj, në asnjë moment Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar se oferta jonë është e papërgjegjshme apo se nuk i plotëson kriteret e dosjes së tenderit.

Përkundrazi, pas shqyrtimit të ankesës sonë, vet Autoriteti Kontraktues ka pranuar se gjatë vlerësimit fillestar ka pasur mungesë dhe parregullsi. Kjo nënkupton qartë se operatori ynë ekonomik është dëmtuar padrejtësisht gjatë procesit të vlerësimit dhe se anulimi i mëvonshëm i procedurës është përdorur si mënyrë për të shmangur korrigjimin e atyre shkeljeve.

Në këtë rast, anulimi i procedurës nuk mund të përdoret si mekanizëm për të eliminuar operatorin ekonomik që ka ofertuar çmimin më të favorshëm dhe që ka përmbushur kushtet e kërkuara. Një veprim i tillë bie ndesh me vet qëllimin e Ligjit për Prokurim Publik, i cili obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë trajtim të barabartë, konkurrencë të drejtë dhe shfrytëzim racional të parasë publike.

Theksojmë se nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur paqartësi lidhur me mënyrën e zbatimit të ndonjë pozicioni teknik, ai ka pasur të drejtë dhe mundësi ligjore që gjatë administrimit të kontratës të bëjë sqarime operative dhe interpretim të drejtë të obligimeve kontraktuale, e jo të anulojë tërësisht procedurën vetëm pasi operatori ynë ekonomik ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave të veta.

Për këtë arsye konsiderojmë se Operatori ynë Ekonomik duhet të trajtohet si operator i përgjegjshëm dhe fitues legjitim i këtij aktiviteti të prokurimit, duke qenë se:

- ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme;
- ka plotësuar kriteret e dosjes së tenderit;
- ka ofertuar çmimin më të ulët;
- nuk është konstatuar asnjë shkelje apo papërgjegjësi nga ana jonë;
- dhe anulimi i procedurës është bërë vetëm pas pranimit të ankesës sonë.

Pergjigjeje në pretendimet e OE.

Siq është sqaruar edhe në letrat standarte:
Aktiviteti prokurimit me titullin: Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë, me nr prokurimit: 613-26-1259-2-2-1, Anulohet për arsyje se paramasa nga njësia e kërkeses është formuluar gabimisht dhe gjatë fazës së rivlerësimit pas pranimit të një kërkese për Rishqyrtim, gjatë Rivlerësimit AK ka konsideruar që paramasa është fomualuar në atë mënyrë që tek Operatorët Ekonomik ka krijuar hamendësim gjatë dorëzimit të ofertave, gjithashtu vlenë të theksohet se gjatë fazës sa ka qene e hapur NJK nuk kemi pasur ansnjë kërkesë për rishqyrtim apo ndonjë kërkesë për Sqarime në DT dhe tek përshkrimi i cmimeve.
Në këtë rastë tek përshkrimi teknik (paramasa) grupacioni 2 pozicioni nr 2.2, vije në kundërshtim me kërkesat e AK pasi paraqitën në specifikacioin e kërkuar në DT, deklarata e dorëzuar nuk janë në harmoni me paramasën nisur nga kjo është krijuar nje konfuzion pasi që i bije që për qdo bartje apo largim të automjetit AK do të paguaj apo shpenzoj nga mjetet e veta, që faktikisht kishte me qenë obligim i pronareve të automjeteve, sepse ky pozicion gjindet në paramasë i cili ka cmim i plotësuar nga të gjithe OE.
Nisur nga ky aspekt AK nuk ka kapacitete financiare që për qdo parking i cili kalon 24 orë të marrë përgjegjësi të paguaj nga buxheti komunës.

Pagesa për parkingun e pa rregullt të cilat kalojnë mbi 24 orë, duhet të faturohet shkelësve të kësaj rregulle dhe jo AK, OE ka qenë të obliguar dhe të dërgojnë në vendin e caktuar nga vetë OE, dhe në këtë rastë pronari i veturave është dashtë ta paguaj taksën deri në max 30€, dhe në këtë rastë ta tërheqë automjetin e vet nga vendi ku e ka dërguar OE.

Sepse AK nuk mund të paguaj gjoba për shkelësit të kësaj rregulle.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë, më dt; 15.05.2026, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së, brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtor i Prokurimit

**Komuna Lipjan**

# NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik*

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:"Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë"
Numri i aktivitetit te prokurimit: 613-26-1259-2-2-1

| Nr. | Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik | Vlera totale e ofertës me çmim te peshuar € |
|---|---|---|
| 1. | GASHI EG SH.P.K. Rr. Qerim Banulla, nr. 16, Lipjan, Kosove | 779.61 |
| 2. | Haris Karameta B.I. Magure, Lipjan | 1,583.20 |
| 3. | Grup i Operatorëve Ekonomik NOI CONSTRUCTION SH.P.K.; Dashnim Jashari B.I. Rruga Haxhi Kleqka, Lipjan | 2,660.10 |
| 4. | Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P.P. Përparimi ; International Security AAH SH.P.K. BANULLË, BANULLË | 3,034.40 |
| 5. | Grup i Operatorëve Ekonomik Clean Work Shines SH.P.K.; GUARD DE CAPITAL SH.P.K. Rr. 24 Maji, Prishtine | 3,124.80 |
| 6. | Grup i Operatorëve Ekonomik REXHA GROUP HS SH.P.K.; VIA EGNATIA SH.P.K. Rr. E Shqiperise, Nr A/6, Lipjan Kosova | 5,3999.10 |

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Komuna Lipjan anulon kete aktivitet te prokurimit per arsye se:
Paramasa nga njësia e kërkeses është formuluar gabimisht dhe gjatë fazës së rivlerësimit pas pranimit të një kërkese për Rishqyrtim, gjatë Rivlerësimit AK ka konsideruar që paramasa është fomualuar në atë mënyrë që tek Operatorët Ekonomik ka krijuar hamendësim gjatë dorëzimit të ofertave, gjithashtu vlenë të theksohet se gjatë fazës sa ka qene e hapur NJK nuk kemi pasur ansnjë kërkesë për rishqyrtim apo ndonjë kërkesë për Sqarime në DT dhe tek përshkrimi i cmimeve.
Në këtë rastë tek përshkrimi teknik (paramasa) grupacioni 2 pozicioni nr 2.2, vije në kundërshtim me kërkesat e AK pasi paraqitën në specifikacioin e kërkuar në DT, deklarata e dorëzuar nuk janë në harmoni me paramasën nisur nga kjo është krijuar nje konfuzion pasi që i bije që për qdo bartje apo largim të automjetit AK do të paguaj apo shpenzoj nga mjetet e veta, që faktikisht kishte me qenë obligim i pronareve të automjeteve dhe OE, sepse ky pozicion gjindet në paramasë i cili ka cmim i plotësuar nga të gjithe OE.
Nisur nga ky aspekt AK nuk ka kapacitete financiare që për qdo parking i cili kalon 24 orë të marrë pergjëgjësi të paguaj nga buxheti komunës.

**08.05.2026**

Emri dhe mbiemri i ZPP: Bekim Shabani

**B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

# KOMUNA E LIPJANIT

## Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar [1]

**08.05.2026**
**Komuna Lipjan, rruga Shqipëria nr 28**

1. GASHI EG SH.P.K. Rr. Qerim Banulla, nr. 16, Lipjan, Kosove
2. Haris Karameta B.I. Magure, Lipjan
3. Grup i Operatorëve Ekonomik NOI CONSTRUCTION SH.P.K.; Dashnim Jashari B.I. Rruga Haxhi Kleqka, Lipjan
4. Grup i Operatorëve Ekonomik Clean Work Shines SH.P.K.; GUARD DE CAPITAL SH.P.K. Rr. 24 Maji, Prishtine
5. Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P.P. Përparimi ; International Security AAH SH.P.K. BANULLË, BANULLË
6. Grup i Operatorëve Ekonomik REXHA GROUP HS SH.P.K.; VIA EGNATIA SH.P.K. Rr. E Shqiperise, Nr A/6, Lipjan Kosova

| **Nr. i prokurimit:** | 613-26-1259-2-2-1 |
|---|---|

**Titulli:** "Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë"

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

*[Tenderi juaj]* është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *[dosjen e tenderit]*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyjeve në vijim:

*[Tenderi i juaj]* është administrativisht e papërgjegjshme:

Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ❑ Nuk i keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet *[Formularin e paraqitjes së tenderit]*
- ❑ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ❑ Nuk e keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ❑ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant te prokurimit;
- ❑ Gabimi(et) aritmetikor i evidentuar(a) është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;
- ❑ Oferta e juaj, ne përputhje me nenin 61.4 është konsideruar si oferte abnormalisht e ulet.
- ❑ *Nëse është e zbatushme, kërkesa tjera formale/administrative.*

---

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt .*

*[Në rast të Grupit të Opereatorëve Ekonomik]*

- ❑ Nuk keni paraqitur një deklaratë të qart se të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe, në rast se grupit i është dhënë kontrata, performancen e kontratës;
- ❑ Nuk keni paraqitur deklaraten e nënshkruar nga secili anëtar, e cila konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë ne mënyre individuale dhe/aponë ndonjë grup tjetër pjesëmarrës në procedurën e njejtë të prokurimit;
- ❑ Nuk keni paraqitur deklaraten e nënshkruar nga të gjithë anëtaret e grupit e cila autorizon partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit;

Partneri juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë

Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe te kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM

**Aktiviteti prokurimit me titullin: Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë, me nr prokurimit: 613-26-1259-2-2-1, Anulohet për arsyje se paramasa nga njësia e kërkeses është formuluar gabimisht dhe gjatë fazës së rivlerësimit pas pranimit të një kërkese për Rishqyrtim, gjatë Rivlerësimit AK ka konsideruar që paramasa është fomualuar në atë mënyrë që tek Operatorët Ekonomik ka krijuar hamendësim gjatë dorëzimit të ofertave, gjithashtu vlenë të theksohet se gjatë fazës sa ka qene e hapur NJK nuk kemi pasur ansnjë kërkesë për rishqyrtim apo ndonjë kërkesë për Sqarime në DT dhe tek përshkrimi i cmimeve.**
**Në këtë rastë tek përshkrimi teknik (paramasa) grupacioni 2 pozicioni nr 2.2, vije në kundërshtim me kërkesat e AK pasi paraqitën në specifikacioin e kërkuar në DT, deklarata e dorëzuar nuk janë në harmoni me paramasën nisur nga kjo është krijuar nje konfuzion pasi që i bije që për qdo bartje apo largim të automjetit AK do të paguaj apo shpenzoj nga mjetet e veta, që faktikisht kishte me qenë obligim i pronareve të automjeteve dhe OE, sepse ky pozicion gjindet në paramasë i cili ka cmim i plotësuar nga të gjithe OE.**
**Nisur nga ky aspekt AK nuk ka kapacitete financiare që për qdo parking i cili kalon 24 orë të marrë përgjëgjësi të paguaj nga buxheti komunës.**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja këtë here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt: Bekim Shabani

Nënshkrim

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OFLIPJAN

**Departamenti i Prokurimit** **Data: 06.05.2026**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 05.05.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Noi Construction shpk, Lipjan rruga Haxhi Kleqka, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë "me nr prokurimit: 613-26-1259-2-2-1, Autoriteti kontraktues nxjerr:

## V E N D I M

**I. Aprovohet Pjesërisht e Bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e paraqitur nga Operatori Ekonomik Noi Construction shpk, Lipjan rruga Haxhi Kleqka, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë "me nr prokurimit: 613-26-1259-2-2-1.

**II. Anulohet Vendimi B58,** të publikuara ne platformen e prokurimit te dates: 30.04.2026.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

## A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Noi Construction shpk, Lipjan rruga Haxhi Kleqka, **ka parashtuar kërkesë për Rishqyrtim** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë "me nr prokurimit: 613-26-1259-2-2-1, ndërsa Autoriteti Kontraktues, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë me datë: 06.05.2026.

Pas shqyrtimit të kerkesës të dorëzuar nga ana e OE ankues, AK bazuar në pretendimet ankimore konsaton se lënda duhet të kthehet në Ri-Vlerësim dhe Ri-Vendosje.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë, më dt; 06.05.2026, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së, brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtor i Prokurimit

# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: *KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN*

Për Aktivitetin e Prokurimit: **613-26-1259-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë**

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

*Noi Construction shpk*
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

*Rr.Haxhi Kleqka, nr.99*
*(Adresa)*

| | |
|---|---|
| *Lipjan* | *14 000* |
| *(Vendi)* | *(Kodi postar)* |
| *045 785 649* | *N/A* |
| *(Numri Telefonit)* | *(Numri i Faks-it)* |

*Labinot Dedushi*
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*
*noiconstruction.shpk@gmail.com*
*(Adresa elektronike)*

*13.05.2026*
*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

*(Nenshkrimi dhe vula)*

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR NOI CONSTRUCTION *LIPJAN*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_______________________________________________

*(Emri i avokatit)*

_______________________________________________

*(Adresa e plotë)*

______________________ ______________________

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

______________________

*(Adresa elektronike)*

______________________ ______________________

*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

| |
|---|
| *Njoftimi per kontrate 16.03.2026*<br>*Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 19.03.2026*<br>*Dorezimi dhe hapja e tenderit 08.04.2026 14:09*<br>*Njoftim mbi vendimi e AK 30.04.2026 16:09*<br>*Leter standarde per tenderuesin e eleminuar 30.04.2026 16:09*<br>*Vendimi mbi vendimin e AK-se 08.05.2026* |

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

| |
|---|
| Hapje elektronike |

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Autoriteti kontraktues gjate udheheqjes së ketij aktiviteti tē prokurimit, nuk ka vepruar ne pajtım me nenet e meposhtme të LPP-së dhe RrPP-se:

- Shkeljet ligjore te LPP-se dhe akteve tjera nen ligjore.
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
- Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 61 Çmimet jo normalisht te ulëta
- Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve Rregullorja për Prokurim Publik, 001/2022
- Neni 17 Dosja e tenderit Neni 41 Tenderët jo-normalisht te ulet
- Neni 97 Shkeljet e renda. Udhëzuesi për Prokurim Publik nr. 001/23
- Neni 10 Sqarimi i tenderëve

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Te nderuar AK, ne perputhje me nenin 108/A te LPP-se, te pakenaqur me njoftimin mbi vendimin tuaj dhe brenda afatit te parapare ligjor i'u drejtohemi me kete kerkese per rishqyrtim te vendimit per dhenie te kontrates nje OE te pa pergjegjshem si dhe rishqyrtimin e ofertes tone.

Në cilësinë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e lartcekur të prokurimit, paraqesim këtë ankesë/kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 08.05.2026, pasi konsiderojmë se vendimi i marrë është i pabazuar në aspektin juridik, procedural dhe faktik, si dhe është në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurim Publik.

Fillimisht theksojmë se Autoriteti Kontraktues paraprakisht e ka pranuar ankesën tonë si të bazuar lidhur me vendimin fillestar për dhënie të kontratës. Kjo nënkupton se gjatë procesit të vlerësimit janë konstatuar parregullsi dhe shkelje procedurale. Megjithatë, në vend që të bëhet rivlerësim i drejtë dhe objektiv i ofertave dhe të vazhdohet procedura në përputhje me kriteret e dosjes së tenderit, Autoriteti Kontraktues ka zgjedhur anulimin e tërësishëm të aktivitetit të prokurimit me arsyetime të paqëndrueshme dhe kontradiktore.

Në arsyetimin e vendimit thuhet se kinse përshkrimi teknik dhe paramasa kanë krijuar "hamendësim" dhe "konfuzion" tek operatorët ekonomikë lidhur me pozicionin 2.2 dhe çështjen e largimit të automjeteve nga parkingu pas 24 orëve. Ky arsyetim nuk qëndron për faktin se gjatë gjithë periudhës së tenderimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim nga asnjë operator ekonomik lidhur me këtë pozitë apo me dokumentacionin tenderues. Të gjithë operatorët ekonomikë kanë ofertuar në bazë të të njëjtit dokumentacion dhe të njëjtave kushte, sepse te gjitha kushtet kane qene te qarta.

Madje, vet fakti që janë pranuar oferta nga operatorë të ndryshëm ekonomikë dëshmon qartë se dosja e tenderit ka qenë e kuptueshme dhe e zbatueshme. Nuk mund të pretendohet pas përfundimit të procedurës dhe pas pranimit të ankesës sonë se dokumentacioni paska qenë i paqartë apo i interpretuar gabimisht.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues në vendimin e tij pretendon se nuk ka kapacitete financiare që për çdo automjet që qëndron mbi 24 orë në parking të marrë përgjegjësi financiare nga buxheti i komunës. Ky pretendim nuk mund të përdoret si bazë ligjore për anulimin e procedurës, sepse çështja e menaxhimit të automjeteve dhe mënyra e largimit të tyre është kompetencë e vet Autoritetit Kontraktues dhe jo barrë financiare që duhet t'i ngarkohet Operatorit Ekonomik **pa bazë ligjore.**

Sipas kushteve të përcaktuara në dosje, Operatorit Ekonomik i është kërkuar që të bëjë largimin e automjeteve të cilat qëndrojnë më shumë se 24 orë në parking. Mirëpo, Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë ligjore që barrën financiare të largimit të automjeteve ta transferojë tek Operatori Ekonomik, pasi Operatori Ekonomik nuk është organ kompetent për shqiptimin e gjobave apo masave administrative ndaj qytetarëve, respektivisht kundervatjeveve, pasi qe menaxheri I kontrates ne fjale nga komuna e urdheron me shkrimin per largimin e automjetit gje qe nenkupton se operatori ekonomik fitues paguhet nga komuna, pasi qe e njejta e obligon.

Komuna, si institucion publik dhe autoritet përgjegjës për menaxhimin e hapësirave publike dhe zbatimin e rregulloreve komunale, ka të drejtë të shqiptojë tiketë/gjobë ndaj pronarit të automjetit që tejkalon afatin e lejuar të parkimit. Pas marrjes së vendimit administrativ apo urdhrit për largim të automjetit, Komuna mund të angazhojë operatorin ekonomik për bartjen e automjetit dhe më pas ta kompensojë operatorin për shërbimin e kryer sipas kontratës.

Prandaj është e paarsyeshme dhe në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit dhe trajtimit të drejtë që **Operatori Ekonomik të obligohet të mbulojë me shpenzimet e veta largimin e automjeteve, ndërkohë që nuk posedon kompetenca publike për shqiptim të masave administrative apo inkasim të detyrimeve ndaj qytetarëve.**

Gjithashtu, ky arsyetim është paraqitur vetëm pas pranimit të ankesës sonë, çka krijon dyshim të bazuar se anulimi i aktivitetit nuk është bërë për arsye reale procedurale, por me qëllim të shmangies së shpalljes së operatorit tonë ekonomik si fitues të kontratës.

Konsiderojmë se me këtë veprim janë cenuar parimet themelore të:
- trajtimit të barabartë;
- proporcionalitetit;
- transparencës;
- konkurrencës së lirë dhe të ndershme;
- si dhe ekonomicitetit në procedurat e prokurimit publik.

Për më tepër, theksojmë se oferta jonë ka qenë oferta më e favorshme ekonomike dhe njëkohësisht oferta më e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. **Operatori ynë ekonomik ka përmbushur të gjitha kërkesat administrative, teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe ka ofertuar në përputhje të plotë me parametrat dhe specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.**

**Çmimi i ofertuar nga ana jonë është dukshëm më i ulët krahasuar me operatorët tjerë ekonomikë, duke i sjellë përfitim të drejtpërdrejtë buxhetit publik dhe duke respektuar parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit të parasë publike. Përkundër kësaj, në asnjë moment Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar se oferta jonë është e papërgjegjshme apo se nuk i plotëson kriteret e dosjes së tenderit.**

Përkundrazi, pas shqyrtimit të ankesës sonë, vet Autoriteti Kontraktues ka pranuar se gjatë vlerësimit fillestar ka pasur mangësi dhe parregullsi. **Kjo nënkupton qartë se operatori ynë ekonomik është dëmtuar padrejtësisht gjatë procesit të vlerësimit dhe se anulimi i mëvonshëm i procedurës është përdorur si mënyrë për të shmangur korrigjimin e atyre shkeljeve.**

Në këtë rast, anulimi i procedurës nuk mund të përdoret si mekanizëm për të eliminuar operatorin ekonomik që ka ofertuar çmimin më të favorshëm dhe që ka përmbushur kushtet e kërkuara. **Një veprim i tillë bie ndesh me vet qëllimin e Ligjit për Prokurim Publik, i cili obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë trajtim të barabartë, konkurrencë të drejtë dhe shfrytëzim racional të parasë publike.**

**Theksojmë se nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur paqartësi lidhur me mënyrën e zbatimit të ndonjë pozicioni teknik, ai ka pasur të drejtë dhe mundësi ligjore që gjatë administrimit të kontratës të bëjë sqarime operative dhe interpretim të drejtë të obligimeve kontraktuale, e jo të anulojë tërësisht procedurën vetëm pasi operatori ynë ekonomik ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave të veta.**

Për këtë arsye konsiderojmë se Operatori ynë Ekonomik duhet të trajtohet si operator i përgjegjshëm dhe fitues legjitim i këtij aktiviteti të prokurimit, duke qenë se:

- ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme;
- ka plotësuar kriteret e dosjes së tenderit;
- ka ofertuar çmimin më të ulët;
- nuk është konstatuar asnjë shkelje apo papërgjegjësi nga ana jonë;
- dhe anulimi i procedurës është bërë vetëm pas pranimit të ankesës sonë.

Prandaj, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të veprojë në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik dhe të vazhdojë procedurën me shpërblimin e kontratës për operatorin tonë ekonomik si operatori më i përgjegjshëm dhe me ofertën më të favorshme ekonomike.

Duke u bazuar ne keto qe pretendimet te elaboruara, propozojme qe te merrni:

- VENDIM

Te aprovohet si e bazuar kerkesa per rishqyrtim e GOE; NOI CONSTRUCTION SHPK & DASHNIM JASHARI B.I.

Te anulohet vendimi I AK-se I shpallur ne lidhje me kete procedure te prokurimit dhe lenda te rikthehet ne **rivleresim.**

**8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Refuzimi i ofertes sone si oferta e pergjegjshme dhe me çmimin me te ulet na privon nga mundesia per realizimin kontrates dhe profitit te planifikuar permes shkeljes se ligjit, i cili ndikon drejtperdrejt ne performancen financiare te kompanise dhe zhvillimin e metutjetshem te aftesive profesionale dhe teknike

**9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

# Komuna Lipjan

## NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik*

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:"Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë"
Numri i aktivitetit te prokurimit: 613-26-1259-2-2-1

| Nr. | Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik | Vlera totale e ofertës me çmim te peshuar € |
|---|---|---|
| 1. | GASHI EG SH.P.K. Rr. Qerim Banulla, nr. 16, Lipjan, Kosove | 779.61 |
| 2. | Haris Karameta B.I. Magure, Lipjan | 1,583.20 |
| 3. | Grup i Operatorëve Ekonomik NOI CONSTRUCTION SH.P.K.; Dashnim Jashari B.I. Rruga Haxhi Kleqka, Lipjan | 2,660.10 |
| 4. | Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P.P. Përparimi ; International Security AAH SH.P.K. BANULLË, BANULLË | 3,034.40 |
| 5. | Grup i Operatorëve Ekonomik Clean Work Shines SH.P.K.; GUARD DE CAPITAL SH.P.K. Rr. 24 Maji, Prishtine | 3,124.80 |
| 6. | Grup i Operatorëve Ekonomik REXHA GROUP HS SH.P.K.; VIA EGNATIA SH.P.K. Rr. E Shqiperise, Nr A/6, Lipjan Kosova | 5,3999.10 |

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Komuna Lipjan anulon kete aktivitet te prokurimit per arsye se:
Paramasa nga njësia e kërkeses është formuluar gabimisht dhe gjatë fazës së rivlerësimit pas pranimit të një kërkese për Rishqyrtim, gjatë Rivlerësimit AK ka konsideruar që paramasa është fomualuar në atë mënyrë që tek Operatorët Ekonomik ka krijuar hamendësim gjatë dorëzimit të ofertave, gjithashtu vlenë të theksohet se gjatë fazës sa ka qene e hapur NJK nuk kemi pasur ansnjë kërkesë për rishqyrtim apo ndonjë kërkesë për Sqarime në DT dhe tek përshkrimi i cmimeve.
Në këtë rastë tek përshkrimi teknik (paramasa) grupacioni 2 pozicioni nr 2.2, vije në kundërshtim me kërkesat e AK pasi paraqitën në specifikacioin e kërkuar në DT, deklarata e dorëzuar nuk janë në harmoni me paramasën nisur nga kjo është krijuar nje konfuzion pasi që i bije që për qdo bartje apo largim të automjetit AK do të paguaj apo shpenzoj nga mjetet e veta, që faktikisht kishte me qenë obligim i pronareve të automjeteve dhe OE, sepse ky pozicion gjindet në paramasë i cili ka cmim i plotësuar nga të gjithe OE.
Nisur nga ky aspekt AK nuk ka kapacitete financiare që për qdo parking i cili kalon 24 orë të marrë përgjegjësi të paguaj nga buxheti komunës.

**08.05.2026**

Emri dhe mbiemri i ZPP: Bekim Shabani

## B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

# KOMUNA E LIPJANIT

## Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar [1]

**08.05.2026**
**Komuna Lipjan, rruga Shqipëria nr 28**

1. GASHI EG SH.P.K. Rr. Qerim Banulla, nr. 16, Lipjan, Kosove
2. Haris Karameta B.I. Magure, Lipjan
3. Grup i Operatorëve Ekonomik NOI CONSTRUCTION SH.P.K.; Dashnim Jashari B.I. Rruga Haxhi Kleqka, Lipjan
4. Grup i Operatorëve Ekonomik Clean Work Shines SH.P.K.; GUARD DE CAPITAL SH.P.K. Rr. 24 Maji, Prishtine
5. Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P.P. Përparimi ; International Security AAH SH.P.K. BANULLË, BANULLË
6. Grup i Operatorëve Ekonomik REXHA GROUP HS SH.P.K.; VIA EGNATIA SH.P.K. Rr. E Shqiperise, Nr A/6, Lipjan Kosova

| **Nr. i prokurimit:** | 613-26-1259-2-2-1 |
|---|---|

**Titulli:** "Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë"

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

*[Tenderi juaj]* është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *[dosjen e tenderit]*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyjeve në vijim:

*[Tenderi i juaj]* është administrativisht e papërgjegjshme:

Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ❑ Nuk i keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet *[Formularin e paraqitjes së tenderit]*
- ❑ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ❑ Nuk e keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ❑ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant te prokurimit;
- ❑ Gabimi(et) aritmetikor i evidentuar(a) është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;
- ❑ Oferta e juaj, ne përputhje me nenin 61.4 është konsideruar si oferte abnormalisht e ulet.
- ❑ *Nëse është e zbatushme, kërkesa tjera formale/administrative.*

---

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt .*

*[Në rast të Grupit të Opereatorëve Ekonomik]*

- ❑ Nuk keni paraqitur një deklaratë të qart se të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe, në rast se grupit i është dhënë kontrata, performancen e kontratës;
- ❑ Nuk keni paraqitur deklaraten e nënshkruar nga secili anëtar, e cila konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë ne mënyre individuale dhe/aponë ndonjë grup tjetër pjesëmarrës në procedurën e njejtë të prokurimit;
- ❑ Nuk keni paraqitur deklaraten e nënshkruar nga të gjithë anëtaret e grupit e cila autorizon partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit;

Partneri juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë

Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe te kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM

**Aktiviteti prokurimit me titullin: Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë, me nr prokurimit: 613-26-1259-2-2-1, Anulohet për arsyje se paramasa nga njësia e kërkeses është formuluar gabimisht dhe gjatë fazës së rivlerësimit pas pranimit të një kërkese për Rishqyrtim, gjatë Rivlerësimit AK ka konsideruar që paramasa është fomualuar në atë mënyrë që tek Operatorët Ekonomik ka krijuar hamendësim gjatë dorëzimit të ofertave, gjithashtu vlenë të theksohet se gjatë fazës sa ka qene e hapur NJK nuk kemi pasur ansnjë kërkesë për rishqyrtim apo ndonjë kërkesë për Sqarime në DT dhe tek përshkrimi i cmimeve.**
**Në këtë rastë tek përshkrimi teknik (paramasa) grupacioni 2 pozicioni nr 2.2, vije në kundërshtim me kërkesat e AK pasi paraqitën në specifikacioin e kërkuar në DT, deklarata e dorëzuar nuk janë në harmoni me paramasën nisur nga kjo është krijuar nje konfuzion pasi që i bije që për qdo bartje apo largim të automjetit AK do të paguaj apo shpenzoj nga mjetet e veta, që faktikisht kishte me qenë obligim i pronareve të automjeteve dhe OE, sepse ky pozicion gjindet në paramasë i cili ka cmim i plotësuar nga të gjithe OE.**
**Nisur nga ky aspekt AK nuk ka kapacitete financiare që për qdo parking i cili kalon 24 orë të marrë përgjëgjësi të paguaj nga buxheti komunës.**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja këtaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt: Bekim Shabani

Nënshkrim

KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN

# NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ ***PUNË*** ☐ ***FURNIZIM*** ☒ ***SHËRBIME***

*Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Data e përgatitjes së njoftimit: 16.03.2026**

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **613-26-1259-2-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | |

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:
Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☐

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar**: **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN** | | |
| **Adresa Postare**: **SHQIPERIA** | | |
| Qyteti: **LIPJAN** | Kodi postar: **14000** | Vendi: **Kosovë** |
| **Personi kontaktues**: **Bekim Shabani** | Telefoni: **+383 20041539** | |
| Email: **bekim.g.shabani@rks-gov.net** | Faksi: | |
| Adresa e Internetit (*nëse aplikohet)*: | | |

Po ☐ Jo ☒
Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒
Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

***Nëse po***, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

## II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**
**Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë**

**II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**
*(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)*

| ☐ **Punë** | ☐ **Furnizime** | ☒ **Shërbime** |
|---|---|---|
| ☐ Ekzekutim<br>☐ Plani dhe ekzekutimi<br>☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | ☐ Blerja<br>☐ Qira financiare (lizing)<br>☐ Qira<br>☐ Blerje me këste<br>☐ Një kombinim i këtyre | |

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
**Parkingu nëntokësorë - Lipjan**

**II.1.3) Njoftimi përfshinë**

Krijimin e kontratës publike kornizë
☒

**II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë** *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☒

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

**Ekzekutimi i kontratës:**

Thirrje/Porosi
☒

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

**Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj** 12

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës**
**Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë**

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):**

93000000-8

**II.1.7) Variantet pranohen**

**Po** ☐ **Jo** ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,*** tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

**II.1.9) Informacione lidhur me pjesët** (*nëse aplikohen)*

| Nr. i pjesës | Emërtimi i grupit | Përshkrimi i shkurtër |
|---|---|---|
| | | |

**Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:**

**II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 59,999.88**

## II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm** *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
**Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë. Sasitë janë të parapara te përshkrimi i çmimeve.**

## II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë (nga dhënia e kontratës)
*apo*
Fillimi
Përfundimi

## NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

## III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

**III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit**

**Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po***, vlera e sigurisë së ekzekutimit **6,000.00€ ne kohezgjatje prej 13 muajve** EUR ose
% e vlerës së kontratës

**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata** *(nëse aplikohet)*:

**III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës**

**Po** ☐ **Jo** ☒

| |
|---|
| ***Nëse po,*** përshkrimi i kushteve të veçanta |

## III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

| **III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
|---|---|
| **1.Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov.net. Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës. 3. Vërtetim nga Gjykata kompetente.** | **1.Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2.Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3.Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a.Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b.Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.** |
| **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| **Kërkesa 1. Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.** | **Deshmia 1. Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.** |
| **III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| | |
| **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| **Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për** | **Dëshmia 1. Nje liste e kontratave e nenshkruar dhe vulosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi** |

| | |
|---|---|
| projekte të ngjashme në vlere prej 80,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat. | me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontrates, vlerën e kontrates, Referencat apo pranimet teknike për kontratat e prezentuara per projekte te ngjashme. Nese kontrata me reference eshte me kompani private te deshmohet me transaksion bankar (deshmi qe eshte kry pagesa). Referencat apo pranimet teknike duhet te jene ne 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat. |
| Kerkesa 2. Lista e pajisjeve a. Automjet per barjten te makinave min 1 copë, b. Makine per pastrimin e dyshemese min 2 copa. | Deshmia 2. Lista e paisjeve e nenshkruar dhe vulosur nga OE, Deklaratat unike doganore ose faturat e blerjes për Paisjet dhe automjetet qe nuk regjistrohen. Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen (valide). Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin e mjeteve-paisjeve, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim te nenshkruar dhe vulosur dhe te gjitha tjerat deshmit perkatese. |
| Kerkesa 3. Lista e stafit a) Min 8 puntor | Deshmia 3. Lista e stafit duhet te dorzohet e nenshkruar dhe e vulosur nga OE. Per te gjith stafin kerkohen Kontratat e punes ose parakontrata per kete projekt. |
| Kerkesa 4. OE duhet te posedoj një parking per vetura jo më larg se 10 km nga parkingu i Komunes | Deshmia 4. Fleta poseduese jo me e vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit te publikimit, ne rast se hapsira mirret per shfrytzim, OE duhet te paraqet marrveshjen per qera per shfrytzimin e kesaj hapsire, e cila duhet te jete ne emer te ketij projekti dhe me afat sa zgjate kjo ky projekt. |
| Kerkesa 5. Deklarata nen betim nga Kompania kontraktuese se qfare shume do te zbatohet ne rastin e terheqjes apo largimit te automjeti nga parkingu, deri në parkingun e OE, vlera max 30€. | Deshmia 5. Deklarata nen betim nga Kompania kontraktuese se qfare shume do te zbatohet ne rastin e terheqjes apo largimit te automjeti nga parkingu, deri në parkingun e OE, vlera max 30€. |

## III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

**Po** ☐ **Jo** ☒

**III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar**

***Nëse po,*** referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

**III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve**

**Po** ☐ **Jo** ☒

## NENI IV: PROCEDURA

## IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

**IV.1.1) Lloji i procedurës**

☒ **E hapur**

☐ **E kufizuar**

☐ **Konkurruese me negociata**

☐ **Kuotim i Çmimit**

**IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim** *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*

Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

**IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave** *(procedurë konkurruese me negociata)*

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

**Po** ☐ **Jo** ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë
kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

**Po** ☐ **Jo** ☐

**IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është**:

**IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik**

Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

## IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët**

*ose*

☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

## IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

**IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,***

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*

| |
|---|
| i<br>i |
| **Po** ☐ **Jo** ☒<br>Dokumentet me pages<br><br>*Nëse po*, çmimi EUR<br>Kushtet dhe metoda e pagesës: |
| **IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:***<br><br>***data* 08.04.2026 *koha* 14:00:00 *vendi* Platforma elektronike e-prokurimi** |
| **IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:**<br>☐ **Po** ☒ **Jo**<br><br>*Nëse po*, jep arsyetim |
| **IV.3.4)** A është e nevojshme siguria e tenderit:<br>**Po** ☒ **Jo** ☐<br><br>*Nëse po*, vlera e sigurisë së tenderit **1000€**<br>Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **90** *apo* muaj |
| **IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:**<br>Deri më: data: ditët **60** apo muajt |
| **IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:**<br><br>**data 08.04.2026 koha 14:00:00 vendi Komuna Lipjan kati 2** |

## NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

### V.1) ANKESAT

| |
|---|
| **Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.** |

### V.2) INFORMACIONET SHTESË

| |
|---|
| **Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.**<br>*Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)* |

,

KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN

# NJOFTIM PER INFORMATA SHTESE
# ose
# PERMIRESIM I GABIMIT

*Sipas Nenit 53 të Ligjit Nr. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92*

☐ **Punë** ☐ **Furnizim** ☒ **Shërbime**

*[Përkujtese: Nëse ndonjë përmirësim i gabimit ose informacion shtese shpije ne një ndryshim rrënjësor të kushteve të parashikuara në njoftimin origjinal te kontratës me një influencë mbi parimin e trajtimit të barabartë dhe në objektivin e prokurimit konkurrues, do të jetë e nevojshme zgjatja e afateve fillimisht te parapara ]*

**Data e përgatitjes te këtij njoftimi:** **16.03.2026**

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **613-26-1259-2-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | |

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☐

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar**: **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN** | | |
| **Adresa Postare**: **SHQIPERIA** | | |
| Qyteti: **LIPJAN** | Kodi postar: **14000** | Vendi: **Kosovë** |
| **Personi kontaktues**: **Bekim Shabani** | | Telefoni: **+383 20041539** |
| Email: **bekim.g.shabani@rks-gov.net** | | Faksi: |
| Adresa e Internetit (*nëse aplikohet*): | | |

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

### II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:** *(ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)*
**Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë**

| |
|---|
| **II.1.2) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës** *(ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)*<br>**Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë** |
| **II.1.3) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):** *(ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)*<br>**93000000-8** |

**NENI III: PROCEDURA**

**III.1) LLOJI I PROCEDURËS**

| |
|---|
| **III.1.1) Lloji i procedurës** *(ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)* |
| ☒ **E hapur** |
| ☐ **E kufizuar** |
| ☐ **Konkurruese me negociata** |
| ☐ **Kuotim i çmimit** |

**III.2) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE**

| |
|---|
| **III.2.1) Data e publikimit të njoftimit origjinal të kontratës:** |

**NENI IV: INFORMACIONET PLOTËSUESE**

| | | |
|---|---|---|
| **IV.1) KY NJOFTIM PERFSHINE**<br>**Përmirësim** ☒ **Informata shtesë** ☐ | | |
| **Njoftim për kontrate** ☒ **Njoftim për dhënie kontrate** ☐ | | |
| **IV.2) INFORMACIONI QE DUHET TE PERMIRESOHER OSE TE SHTOHET** *(nëse aplikohet; te specifikohet vendi i tekstit ose datat te cilat duhet te përmirësohen apo te shtohen, ju lutem gjithmonë ofroni nenet përkatëse & numrin e paragrafit te njoftimit origjinal)* | | |
| **IV.2.1) Modifikimi i informatave** ☒ **origjinale të dorëzuara nga Autoriteti Kontraktues** | **Publikimi në webfaqen e KRPP-së** ☐ **nuk është në përputhje me informatat origjinale të dorëzuara nga Autoriteti Kontraktues** | **Të dyja** ☐ |
| **IV.2.2) Në njoftimin origjinal** ☐ | **Në dokumentet e tenderit** ☐ | **Të dyja** ☒ |
| **IV.2.3) Teksti i cili duhet të përmirësohet/shtohet në njoftimin origjinal** *(nëse aplikohet)* | | |
| Vendi i tekstit i cili duhet të modifikohet: | Në vend të: | **Është** : |
| **Pershkrimi i çmimeve** | **Pershkrimi i çmimeve** | **Pershkrimi i çmimeve** |
| **Dosja e tenderit- specifikimet** | **Dosja e tenderit- specifikimet** | **Dosja e tenderit- specifikimet** |

| teknike | teknike | teknike |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

-------------------------------------- *(Shto nenin IV.2.3 sa here qe keni nevoje)* ------------------------------

# PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

| | | | |
|---|---|---|---|
| Numri i prokurimit<br>Procurement number<br>Broj nabavke: | **613-26-1259-2-2-1** | Titulli i Kontratës<br>Contract Title<br>Naslov ugovoru | **Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë** |
| Numri i brendshëm<br>Internal No<br>Interni broj | | | |

| Data e lëshimit<br>Date of issue<br>Datum izdavanja | Data e mbylljes<br>Closing date<br>Datum zatvaranja & Čas | Data e hapjes & Ora<br>Opening date & time<br>Datum Otvaranja & Čas | Vendi<br>Place<br>Mesto | Nr. i tenderëve të pranuar<br>No. of Received Tenders<br>Br. Primljenih Tendera |
|---|---|---|---|---|
| **08.04.2026** | **08.04.2026, 14:00:00** | **08.04.2026, 14:00:00** | **Komuna Lipjan kati 2** | **6** |

| Nr.<br>Br. | Tenderuesi<br>Tenderer<br>Tenderer | Kodi i tenderit<br>Tender label /code<br>Oznaka ponude | Pjesë<br>Lot<br>Lot | e-tenderit<br>e-tender<br>e-ponuda | Çmimi<br>Price<br>Cena<br>€ | Çmimi (me TVSh)<br>Price (with VAT)<br>Cena (sa PDV)<br>€ | Ndryshimi/plotësimi<br>Suplement/Amendment<br>Dpuna/Izmjena |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.** | **Grup i Operatorëve Ekonomik Clean Work Shines SH.P.K.; GUARD DE CAPITAL SH.P.K., Rr. 24 Maji, 10000, Prishtine** | **oferta 1** | **Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë** | **PO** | **2648.14** | **3124.80** | **JO** |
| **2.** | **Haris Karameta B.I., Magure, 14000, Lipjan** | **613-26-1259-2-2-1** | **Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë** | **PO** | **1341.69** | **1583.20** | **JO** |
| **3.** | **Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P.P. Përparimi ; International Security AAH SH.P.K., BANULLË, -, BANULLË** | **0804** | **Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë** | **PO** | **2571.53** | **3034.40** | **JO** |
| **4.** | **Grup i Operatorëve Ekonomik NOI CONSTRUCTION SH.P.K.; Dashnim Jashari B.I., Rruga Haxhi Kleqka, 14000, Lipjan** | **MN** | **Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë** | **PO** | **2254.32** | **2660.10** | **JO** |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5. | Grup i Operatorëve Ekonomik REXHA GROUP HS SH.P.K.; VIA EGNATIA SH.P.K., Rr. E Shqiperise, Nr A/6, 14000, Lipjan Kosova | 08.04.2026- Mn | Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë | PO | 44279.26 | 53999.10 | JO |
| 6. | GASHI EG SH.P.K., Rr. Qerim Banulla, nr. 16, 14 000, Lipjan, Kosove | 001-LP-26 | Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë | PO | 660.69 | 779.61 | JO |

## Përfaqësuesi i OE / EO Representative / Zastupnik EO

| Nr.<br>Br | Tenderuesi, Emri / Mbiemri<br>Tenderer, Name / Surname<br>Tenderer, Ime / Prezime | Nënshkrimi<br>Signature<br>Potpis |
|---|---|---|
| | | |
| | | |

## Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

| Emri Mbiemri<br>Name Surname<br>Ime Prezime | Nënshkrimi/ Signature/ Potpis | Datë/ Date/ Datum |
|---|---|---|
| Bekim Arifi | [signature] | 08. 04. 2026 |
| Samire Dragaqina | [signature] | 08. 04. 2026 |
| Vlora Sadiku | | |
| Burim Ramadani | | |
| | | |

**Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:**

**Bekim Shabani**

[signature]

* Procurement officer shall appoint a tender opening commission.

**Komuna Lipjan**

## NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik*

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:"Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë"
Numri i aktivitetit te prokurimit: 613-26-1259-2-2-1

| Nr. | Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik | Vlera totale e ofertës me çmim te peshuar € |
|---|---|---|
| 1. | GASHI EG SH.P.K. Rr. Qerim Banulla, nr. 16, Lipjan, Kosove | 779.61 |
| 2. | Haris Karameta B.I. Magure, Lipjan | 1,583.20 |
| 3. | Grup i Operatorëve Ekonomik NOI CONSTRUCTION SH.P.K.; Dashnim Jashari B.I. Rruga Haxhi Kleqka, Lipjan | 2,660.10 |
| 4. | Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P.P. Përparimi ; International Security AAH SH.P.K. BANULLË, BANULLË | 3,034.40 |
| 5. | Grup i Operatorëve Ekonomik Clean Work Shines SH.P.K.; GUARD DE CAPITAL SH.P.K. Rr. 24 Maji, Prishtine | 3,124.80 |
| 6. | Grup i Operatorëve Ekonomik REXHA GROUP HS SH.P.K.; VIA EGNATIA SH.P.K. Rr. E Shqiperise, Nr A/6, Lipjan Kosova | 5,3999.10 |

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Komuna Lipjan shpërblen me kontratë GASHI EG SH.P.K. Rr. Qerim Banulla, nr. 16, Lipjan, Kosove në vlerë totale të ofertës 779.61€

**30.04.2026**

Emri dhe mbiemri i ZPP: Bekim Shabani

**B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

# KOMUNA E LIPJANIT

## Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm[1]

**30.04.2026**

Komuna Lipjan, rruga Shqipëria nr 28.

GASHI EG SH.P.K. Rr. Qerim Banulla, nr. 16, Lipjan, Kosove

| **Nr i Prokurimit** | 613-26-1259-2-2-1 |
|---|---|

**Titulli:** Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë

I/e nderuar(a) Z. Egzon Gashi

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët si përgjigje ndaj njoftimit të kontratës për aktivitetin e prokurimit te lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj prej **779.61€** dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit te intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Me respekt: Bekim Shabani

Nënshkrimi

---

[1] *Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata*

**KOMUNA E LIPJANIT**

**Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm** [1]

30.04.2026

Komuna Lipjan ,rruga Shqipëria nr 28

1. Haris Karameta B.I. Magure, Lipjan
2. Grup i Operatorëve Ekonomik NOI CONSTRUCTION SH.P.K.; Dashnim Jashari B.I. Rruga Haxhi Kleqka, Lipjan
3. Grup i Operatorëve Ekonomik Clean Work Shines SH.P.K.; GUARD DE CAPITAL SH.P.K. Rr. 24 Maji, Prishtine

| **Nr. i prokurimit:** | 613-26-1259-2-2-1 |
|---|---|

**Titulli:** "Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë"

I/e nderuar(a) Z.

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj nuk qe tenderi me çmimin më të ulët në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë GASHI EG SH.P.K. Rr. Qerim Banulla, nr. 16, Lipjan, Kosove **për një shumë prej 779.61€**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.
Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .
Njoftimi i dhënies së kontratës është i publikuar ne platformën elektronike.

Me respekt: Bekim Shabani

Nënshkrimi

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve që i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktues, të paraqitura në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit, por të cilëve nuk u është dhënë kontrata, ngase tenderët e tyre nuk qenë nga më të mirët sipas kriterit për dhënien e kontratës.*

# KOMUNA E LIPJANIT

## Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar [1]

**30.04.2026**
**Komuna Lipjan, rruga Shqipëria nr 28**

Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P.P. Përparimi ; International Security AAH SH.P.K.
BANULLË, BANULLË

| Nr. i prokurimit: | 613-26-1259-2-2-1 |
|---|---|

**Titulli:** "Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë"

I/e nderuar(a) Amir Sahiti

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

*[Tenderi juaj]* është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *[dosjen e tenderit]*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyjeve në vijim:

*[Tenderi i juaj]* është administrativisht e papërgjegjshme:

Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ❑ Nuk i keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet *[Formularin e paraqitjes së tenderit]*
- ❑ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ❑ Nuk e keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ❑ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant te prokurimit;
- ❑ Gabimi(et) aritmetikor i evidentuar(a) është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;
- ❑ Oferta e juaj, ne përputhje me nenin 61.4 është konsideruar si oferte abnormalisht e ulet.
- ❑ *Nëse është e zbatushme, kërkesa tjera formale/administrative.*

*[Në rast të Grupit të Opereatorëve Ekonomik]*
- ❑ Nuk keni paraqitur një deklaratë të qart se të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe, në rast se grupit i është dhënë kontrata, performancen e kontratës;

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt.*

- ☐ Nuk keni paraqitur deklaraten e nënshkruar nga secili anëtar, e cila konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë ne mënyre individuale dhe/aponë ndonjë grup tjetër pjesëmarrës në procedurën e njejtë të prokurimit;
- ☐ Nuk keni paraqitur deklaraten e nënshkruar nga të gjithë anëtaret e grupit e cila autorizon partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit;

Partneri juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë

Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe te kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM

**Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye se ju mungon lista e paisjeve.**

**Sqarim: Autoriteti Kontraktues me ane te letres standarde te kerkeses per sqarimin e tenderit ka kerkuar sqarime shtese, mirpo ju nuk jeni pergjigjur fare brenda afateve ligjore te parapara me Legjislacionin e Prokurimit Publik ne fuqi.**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt: Bekim Shabani

Nënshkrimi

# KOMUNA E LIPJANIT

## Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar [2]

**30.04.2026**
**Komuna Lipjan, rruga Shqipëria nr 28**

Grup i Operatorëve Ekonomik REXHA GROUP HS SH.P.K.; VIA EGNATIA SH.P.K. Rr. E Shqiperise, Nr A/6, Lipjan Kosova

| **Nr. i prokurimit:** | 613-26-1259-2-2-1 |
|---|---|

**Titulli:** "Mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë"

I/e nderuar(a) Zahide Thaçi Sopa

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

*[Tenderi juaj]* është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *[dosjen e tenderit]*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyjeve në vijim:

*[Tenderi i juaj]* është administrativisht e papërgjegjshme:

Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ❑ Nuk i keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet *[Formularin e paraqitjes së tenderit]*
- ❑ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ❑ Nuk e keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ❑ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant te prokurimit;
- ❑ Gabimi(et) aritmetikor i evidentuar(a) është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;
- ❑ Oferta e juaj, ne përputhje me nenin 61.4 është konsideruar si oferte abnormalisht e ulet.
- ❑ *Nëse është e zbatushme, kërkesa tjera formale/administrative.*

*[Në rast të Grupit të Opereatorëve Ekonomik]*
- ❑ Nuk keni paraqitur një deklaratë të qart se të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe, në rast se grupit i është dhënë kontrata, performancen e kontratës;
- ❑ Nuk keni paraqitur deklaraten e nënshkruar nga secili anëtar, e cila konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë ne mënyre individuale dhe/aponë ndonjë grup tjetër pjesëmarrës në procedurën e njejtë të prokurimit;

---
[2] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt.*

❑ Nuk keni paraqitur deklaraten e nënshkruar nga të gjithë anëtaret e grupit e cila autorizon partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit;

Partneri juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë

Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe te kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM

**Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye se ju mungon lista e kontratave-referencave.**

**Sqarim: Autoriteti Kontraktues me ane te letres standarde te kerkeses per sqarimin e tenderit ka kerkuar sqarime shtese, mirpo ju nuk jeni pergjigjur fare brenda afateve ligjore te parapara me Legjislacionin e Prokurimit Publik ne fuqi.**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt: Bekim Shabani

Nënshkrimi